

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: "Arton I. Berisha" B.I. & N.T.SH. "GARAGE - BENZ" & N.N.T. "Etniku" – Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	16.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **15.03.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **"Arton I. Berisha" B.I. & N.T.SH. "GARAGE - BENZ" & N.N.T. "Etniku"** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MIRËMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE**, me Numër të prokurimit: **623-21-191-2-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-001-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **"Arton I. Berisha" B.I. & N.T.SH. "GARAGE - BENZ" & N.N.T. "Etniku"** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MIRËMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE**, me Numër të prokurimit: **623-21-191-2-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-001-2-2-1**, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: **10.03.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **MIRËMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE**, me Numër të prokurimit: **623-21-191-2-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-001-2-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik: "Arton I. Berisha" B.I. & N.T.SH. "GARAGE - BENZ" & N.N.T. "Etniku" me adresë në Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **MIRËMBAJTJA DHE SERVISIMI I AUTOMJETEVE**, me Numër të prokurimit: 623-21-191-2-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-001-2-2-1, kundër Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues, të datës: 10.03.2021, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 15.03.2021, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje duke shpallur fitues Operatorin Ekonomik N.T.SH. "NEZIRI – N" dhe keni vendosur për të dhënë kontratën Operatori Ekonomik që nuk i plotëson kriteret e tenderit të parashtruara nga ana juaj

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues e kemi respektuar plotësisht Nenin 59 të LPP – së, paragrafi 4, ku thotë: **"Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"**.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Njoftimit për Kontrat dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)

Ne si Autoritet Kontraktues kemi respektuar plotësisht Nenin 7, paragrafi 1 të LPP-së, ku thotë: **"Autoriteti Kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"**,

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2.

Lidhur me pretendimin ankimor se Operatori Ekonomik N.T.SH. "NEZIRI – N" nuk ka qarkullim të mjaftueshëm për plotësimin e kriterit të Dosjes së Tenderit të Kapacitetit Ekonomik dhe financiar. Operatori Ekonomik N.T.SH. "NEZIRI – N" nuk ka qarkullim të mjaftueshëm, d.m.th. Deklaratat Tatimore Vjetore të kërkuara nga ana juaj ishin me vlerë: 120,000.00 €uro, ndërsa Operatori Ekonomik N.T.SH. NEZIRI-N ka dorëzuar se Deklaratat Vjetore të Operatori Ekonomik në fjale nuk i përmbushin kërkesa e juaja ngase Operatori në fjale ka qarkullim me vlerë prej: 119,446.80 €uro që nuk i përmbush kërkesat që keni kërkuar ju si Autoriteti Kontraktues.

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues e kemi respektuar plotësisht Nenin 68 të LPP-së, ku thotë:

Qëllimi i këtij kriteri është që të vlerësojë nëse tenderuesi ka stabilitetin e të mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të përformuar kontratën e propozuar. Në përgjithësi, Operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna në vijim:

- 1.1. raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka;
- 1.2. evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;
- 1.3. kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilanci e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose
- 1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur; ose
- 1.5. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, bazuar në nenin e mësipërm AK është i obliguar që të pranojë njërin nga cila do format e mësipërme, ku si rrjedhojë e kësaj OE e ka plotësuar këtë kriter sipas Njoftimit për Kontrat dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), të Kapaciteti ekonomik dhe financiar, duke dorëzuar Deklarata Tatimore Vjetore nga ATK-ja në vlerë prej: **119,446.80 €**, po ashtu ka dorëzuar dhe **Qarkullim nga Banka**, ku sipas Raporteve të dorëzuar nga Banka, *originale të nënshkruara dhe të vulosur nga Banka* janë në vlerë prej: **182,135.52 €**

Ju sqarojmë se edhe OSHP në vendimet e saj e ka konstatuar një gjë të tillë, p.sh në vendimin nr. **79/19** të datës: 07.03.2019 dhe në shumë vendime tjera.

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, duke e refuzuar ofertën e juaj si oferta me çmim jo normalisht e ulët

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.03.2021, me formular: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktues *duke cekur*:

☐ **Sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së**, ku thotë: *Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.*

Pas marrjes të informacionit dhe sqarimit të dorëzuara nga ana juaj, ne si Autoriteti Kontraktues vendosëm se tenderi juaj është jo-normalisht i ulët, nuk keni bashkëngjitur asnjë dëshmi/provë se i posedon këto pajisje/artikujt në stok, meqenëse nuk keni dërguar sqarime të besueshme me Dokumente Unik Doganor (DUD) se ju keni importuar lëndën e parë dhe nuk kemi dëshmuar se ju me fatura dhe ne stok real se keni shenja në stokun tuaj, andaj sqarimi juaj nuk është bindës,

Dhe nga sqarimet e dhëna si me lartë vërtetohet se çmimet për poz. 3 – Fellnet Alumini, 5 – Reduktori, 19 – Sensor para të frenave, 22 – Frejtë tambur mbrapa (Dobosh i frenimit mbrapa), 23 – Huja e rrotës (zgllobi – nyja), 52 – Mbajtes i Sponave, 69 – Korpa (Shporta), 71 – Gome federi, 102 – Ventilatori i ftohësit, keni ofertuar me çmim: 0.01 €, ku këto pozicionet nuk janë me çmim të tregutë, por janë çmimet jo-normalisht të ulëta.

Me datë: 05.03.2021 ju kemi dërguar Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, ku kemi cekur: **Konform nenit 61 të LPP kërkojmë nga ju të na jepni shpjegime detale se si do të realizoni këto pozicione, ne raste se shpjegim i detalsuem për të gjitha pozicionet veçmas dhe shpjegimi është i maget, tenderit juaj do të refuzohet**, andaj tenderi juaj është refuzuar pasi që sqarime dhe shpjegime për pozicione janë të mangëta apo nuk janë dorëzuar fare sqarime po vetëm janë cekur se shumica e pjesëve veq janë në stok.

Ju sqarojmë se edhe OSHP në vendimet e saj e ka konstatuar një gjë të tillë, p.sh në vendimin nr. **322/19** dhe në shumë vendime tjera.

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4.

Lidhur me pretendimin ankimor se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje, duke e refuzuar ofertën e juaj pasi që nuk e ka përmbushur Deklaratën për Specifikime teknike

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ne se i Autoriteti Kontraktues e kemi respektuar plotësisht Nenin 59 të LPP – së, paragrafi 4, ku thotë: *“Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.*

Ju si Operatori Ekonomik nuk e keni plotësuar Deklaratën për Specifikime teknike, që është pjesë e Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), ku me datë:

10.03.2021, me formular: **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuari**, jeni njoftuar nga Autoriteti Kontraktues në formë ligjore duke cekur: **Në ofertën e juaj të dorëzuar mungon Deklarata për Specikime Teknike të Detyrueshme dhe nuk jepni asnjë dëshmi se do ti përmbushni të gjitha specifikat teknike sipas ANKESIT 1 të Dosjes se tenderit, prandaj sipas RrUOPP-së, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve thotë: Mungon Deklarata për Specifikat teknike – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm – Neni 28 i LPP-së.**

Andaj ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit